



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, BUJQËSISË, MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. 1041 / prot.

Gramsh, më 20 / 04 / 2021

Lënda : **Dërgim informacioni .**

Drejtuar : **ZNJ. FATBARDHA NERGJONI**

Adresa: Hotel Turizmi Skampa

ELBASAN

Në përgjigje të tuajës nr.313 prot, datë 12.03.2021, në tonën NR REGJ 1041, datë 17.03.2021, ju informojmë si më poshtë vijon:

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 57/2020 "Për Pyjet", të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullësor" të ndryshuar, si dhe të nenit 801 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", në mbështetje të VKM-së nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive", të VKM-së nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006", "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", dhe të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik".

- Drejtoria e Shërbimit pyjor si strukturë përgjegjëse për pyjet/kullotat pranë bashkisë, ushtron kontrollin për zbatimin e lejeve.
- Nga kontrollet e ushtruara nga specialistët e zonave pyjore përkatëse nuk janë raportuar parregullësi.
- Si pasojë e mos kostatimeve të shkeljeve nuk ka raport të parregulësive.
- Drejtoria e Shërbimit pyjor si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë bashkisë mund të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në planin e rehabilitimit dhe kushtet e Lejes Mjedisore si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

Duke J'u falenderuar.

KRYETARI
Klodian TACE